

V E N D I M
Nr. 495, datë 14.8.2001

**PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE QË DALIN TË PAPUNË NGA PROCESI I
RISTRUKTURIMIT TË ALBTELECOM, SH.A. - SË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr. 8810, datë 17.5.2001 "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime "Albtelecom", sh.a.", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Punonjësit, që dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit të "Albtelecom", sh.a.- së, në periudhën nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi deri në çastin e privatizimit të shoqërisë, përfitojnë kompensim, për një periudhë 2-vjeçare, në masën 100 për qind të pagës bazë të pozicionit (në punë), në çastin e largimit të tyre.

2. Për efekt pensioni, periudha e mësipërme e kompensimit të njihet si vjetërsi në punë dhe të shënohet e tillë në librezën e punës.

3. Përfitojnë nga ky vendim të gjithë punonjësit e sotëm të "Albtelecom", sh.a.-së, që kanë punuar në këtë shoqëri për një periudhë jo më pak se 2 vjet.

4. Të drejtën e kompensimit, në përputhje me këtë vendim, e përfitojnë ata punonjës të cilët nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike në formën e punësimit apo të vetëpunësimit. Në rast të kundërt, u ndërpritet kompensimi që përfitojnë sipas këtij vendimi.

5. Të gjitha fondet e nevojshme për kompensimin e këtyre punonjësve dhe detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore të mbulohen nga të ardhurat e Albtelecom, sh.a.-së, përpara përfundimit të procesit të privatizimit. Pas përfundimit të proesit të privatizimit këto fonde të mbulohen nga të ardhurat e privatizimit.

6. Paga e punonjësve që përfitojnë kompensim dhe pagesa e detyrimeve për sigurimin shoqëror e shëndetësor të tyre të bëhet çdo muaj, nga zyrat e punësimit në rrethet përkatëse.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Financave për nxjerrjen e udhëzimit përkatës dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta